

## VENDIM I ORTAKËVE NR 3

### TË SHOQËRISË "Prosound" SHPK

Sot më datë 28.03 2024, ora 10:00 pranë shoqërisë "Prosound" shpk, regjistruar në QKB me NUIS K623200120, me adresë në Rruga e Kavajes, ish Misto Mame, Zona Kadastrale 8240, Tiranë, zhvillohet Asambleja e Ortakëve në ambientet e shoqërisë.

Ortakët prezent në mbledhje:

- **Z. Kliton Gjika**, titullar i 1 (një) kuote që përbën 90% (nëntëdhjetë përqind) të kapitalit themeltar të shoqërisë;
- **Z. Angjello Gjika**, titullar e 1 (një) kuote që përbën 10% (dhjetë përqind) të kapitalit themeltar të shoqërisë;

### RENDI I DITËS

1. Shqyrtimi lidhur me transferimin e kuotave të shoqërisë pa kundërshpërblim (dhurimin) nga ortaku Kliton Gjika tek ortaku Angjello Gjika.



Pas shqyrtimit të rendit të ditës ortakët e shoqërisë vendosën:

### VENDIM

1. Miratohet dhurimi i 5% (pesë përqind) të kapitalit të shoqërisë nga ortaku Kliton Gjika tek ortaku Angjello Gjika.
2. Ortakët do të zotërojnë përkatësisht:
  - Z. Kliton Gjika, 1 (një) kuotë në masën 85% (tetëdhjetë e pesë) përqind të kapitalit
  - Z. Angjello Gjika, 1 (një) kuotë në masën 15 % (pesëmbëdhjetë përqind) të kapitalit.

Vendimet që janë marrë konsiderohen si të drejta; asgjë tjetër nuk vendoset dhe ortakët e mbyllin mbledhjen e Asamblesë së Ortakëve në orën 10:30.

### ORTAKËT E SHOQËRISË



Kliten Gjika  
Z.Kliten Gjika



"Prosound" shpk

Angjello Gjika  
Z.Angjello Gjika



## KONTRATË TRANSFERIMI KUOTA KAPITALI

### (DHURIM)

Sot me datë 28.032024 në mbështetje të Neneve 761 e vijues të Kodit Civil, Ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008 “Per Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar; nënshkruhet kjo Kontratë midis palëve:

**Z. Kliton Gjika**, shtetas shqiptar, identifikuar me numër ID H70821103M madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar (referuar më poshtë si “**Dhuruesi**”)

dhe


**Z. Angjello Gjika**, shtetas shqiptar, identifikuar me numër ID I30326128E, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar, (referuar më poshtë si “**Pranuesi**”)

Dhuruesi dhe Pranuesit do të referohen më poshtë veçmas si “**Pala**” dhe bashkarisht si “**Palët**”.

### **MEQENËSE**

- Dhuruesi zotëron një kuotë në masën 90% (nëntëdhjetë përqind) të kapitalit të shoqërisë “Prosound” shpk me NUIS K623200120, me kapital të regjistruar prej 115.649.412,00 (njëqind e pesëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind e dyzet e nëntë e katërqind e dymbëdhjetë ) lekë dhe adresë në Rruga e Kavajes, ish Misto Mame, Zona Kadastrale 8240, Tiranë
- Pranuesi zotëron një kuotë në masën 10 % (dhjetë përqind) të kapitalit të shoqërisë Prosound shpk me NUIS K623200120, me kapital të regjistruar prej 115.649.412,00 (njëqind e pesëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind e dyzet e nëntë e katërqind e dymbëdhjetë ) lekë dhe adresë në Rruga e Kavajes, ish Misto Mame, Zona Kadastrale 8240, Tiranë.
- Dhuruesi synon t'i dhurojë Pranuesit 5% (pesë përqind) të kapitalit të shoqërisë “Prosound” shpk.

Palët kanë rënë dakord për lidhjen e Kontratës me kushtet e mëposhtme:



**Neni 1**



## Objekti i Kontratës

1.1 Dhuruesi dhuron, dhe Pranuesi pranon 5% (pesë përqind) të kapitalit të shoqërisë “Prosound” shpk, shoqëri me përgjegjesi të kufizuar, e themeluar në perputhje me legjislacionin e Republikës së Shqipërisë, NUIS K623200120, me seli Rruga e Kavajes, ish Misto Mame, Zona Kadastrale 8240, Tiranë.

## Neni 2

### Efektet e Kontratës

2.1 Duke filluar nga data e kësaj marrëveshje Dhuruesi do të zotërojë 85 % (tetëdhjetë e pesë përqind) të kapitalit të shoqërisë.

2.2 Pranuesi do të zotërojë 15 % (pesëmbëdhjetë përqind) të kapitalit të shoqërisë.

2.3 Numri i përgjithshëm i kuotave do të vijojë të jetë 2 (dy), nga ku 1 (një) kuotë në zotërim të Dhuruesit dhe 1 (një) kuotë në zotërim të Pranuesit.

## Neni 3

### Të Ndryshme

3.1 Dhuruesi deklaron se nuk ka asnjë kufizim mbi të drejtat mbi kapitalin e shoqërisë “Prosound” shpk dhe se ato janë të lira kundrejt çdo lloj kufizimi, barre apo detyrimi.

3.2. Në rast mosmarrëveshje të palëve mbi kushtet, detyrimet dhe interpretimin e kësaj kontrate, palët do të bëjnë të gjitha përpjekjet e mundshme për t'i zgjidhur me mirëkuptim. Në rast të kundërt Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë do të jetë kompetente për zgjidhjen e këtyre mosmarrëveshjeve.

3.3 Kjo Kontratë përpilohet në 2 (dy) kopje me vlerë të njëjtë ligjore.

3.4. Kjo Kontratë hyn në fuqi me nënshkrimin nga palët.



PALËT

